

Novica (Miško) Vujisić

(1.01.1980, serb nga Duboçaku/Duboçak, komuna e Pejës/Peç, nxënës)

Izeti ka punuar në *Elektro-distribucion* në Deçan/Deçane. Me familje jetonte në Raushiq/Raušić. Në muajin prill të vitit 1998, ai me familje u zhvendosën në Malin e Zi. Vučić dhe familja e tij, në muajin maj të vitit 1998, e kanë braktisur fshatin e vet të Dubovikut/Dubovik dhe u strehuan në kodrën Çakor [Mali i Zi]. Në datën **18.06.1998**, Izeti dhe Vučić u nisën me makinën e Izetit të tipit *Zastava* për në Kosovë. Izetit i duhej që të lajmërohej në punë, ndërkaq Vučić u nis për ta kontrolluar shtëpinë. Rrugës e sipër, e kanë takuar Novicën, i cili me biçikletë shkonte në shtëpi, në Duboçak/Duboçak. Personi i fundit që i shihte të gjallë që të tre udhëtarë, ishte vëllai i Novicës, Vesko. Ishin duke pushuar në kafenenë *Slavica*, e cila gjendet te varrezat në lagjen *Dardania/Brežanik* [Pejë/Peç]. Që të tre ishin parë, po ashtu, nga fundi i muajit qershor të vitit 1998, në burgun e UÇK-së në *Jabllanicë/Jablanica* [Gjakovë/Đakovica]. Pas tri apo katër ditësh, ushtarët e UÇK-së i kanë çuar që të tre në drejtim të panjohur. Fati i tyre nuk është ndriçuar as deri më sot. Rastet e zhdukjes së tyre janë të evidentuar nga KNKK-ja, në lëndët që i mbajnë numrat: Izeti - YUK-050075-01, Vučić - YUK-050073-01 dhe Novica - YUK-802835-01.

Burimet: deklarata R.R, FDH-20487; deklarata S.G, FDH-18827; deklarata Š.G, FDH-23499; Sindikat radnika JP Elektrokosmet, *Stradanja...*, 50; KNKK, *Persona të zhdukur...*, FDH-9795; USCG KGDH, *Regjistri...*, FDH-8817; Z. Stijović, *Kosmet...*, 111; *Dnevnik od 17. do 23. juna*, Ilustrovaná politika, 27.06.1998, FDH-18837; SMIP, *Teroristički...*, III, 960, 972; ICTY, IT-04-84 (R.Haradinaj dhe të tjerë), aktgjykimi, 03.04.2008, [http://www.hlc-rdc.org/index.php?lid=sr&show=PravdaIReforma&int_cid=124&cat=Transkripti/Predmet-Haradinaj-i-drugi-\(-IT-04-84-\).](http://www.hlc-rdc.org/index.php?lid=sr&show=PravdaIReforma&int_cid=124&cat=Transkripti/Predmet-Haradinaj-i-drugi-(-IT-04-84-).)

Misin (Sali) Berisha

(1950, ashkali nga Glllogjani/Glodane, komuna e Pejës/Peç, bujk, gjashtë fëmijë)

Sali (Misin) Berisha

(1977, ashkali nga Glllogjani/Glodane, komuna e Pejës/Peç, bujk, i pamartuar)

Xhevat (Misin) Berisha

(1986, ashkali nga Glllogjani/Glodane, komuna e Pejës/Peç, i pamartuar)

Misini, bashkëshortja Ajmone dhe pesë djemtë e tyre nuk posedonin shtëpinë dhe tokën në pronësi të vet dhe, rrjedhimisht, shpesh e ndërronin vendbanimin. Në vitin 1995, ata u strehuan në lokalet e shkollës fillore të **Glllogjanit/Glodane**. Po ashtu, ditën e pacaktuar në muajin **korrik të vitit 1998**, Misini me djemtë Saliun dhe Xhevatin u nisën me qerren e kuajve jashtë fshatit. Nuk janë kthyer kurrë më. Trupat e tyre janë identifikuar me analizën ADN, pasi që u nxorën nga kanali i ***Liqenit të Radoniqit/Radonjičko jezero***. Obduksioni ka konstatuar se ishin vrarë me të shtëna nga armë zjarri. Familjarët u njoftuan zyrtarisht për rezultatet e identifikimit në fund të muajit mars të vitit 2009. Mbetjet mortore të Misinit, Xhevatit dhe Saliut u varrosën në varrezat e Belegut/Beleg [Deçanit/Deçani] më 16.04.2009.

Burimet: deklarata L.T, FDH-29582; *Predati i sahranjeni*, Oteta istina nr. 18, prill-qershor 2009, 38, FDH-26312; KNKK, *Persona të zhdukur...*, FDH-9795; Z. Stijović, *Kosmet...*, 108, 109; ICTY, IT-04-84 (R.Haradinaj dhe të tjerë), aktgjykimi, 03.04.2008,

Vedat (Riza) Komoni

(8.11.1966, shqiptar nga Peja/Peç, punëtor, i pamartuar)

Vedati me familje jetonte në lagjen *Dardania III/Brežanik III* në Pejë/Peç. Familjarët e tij e kanë braktisur shtëpinë më **5.07.1998**, kur në fshatin fqinj të Loxhës/Loda filluan përlëshjet e armatosura në mes të policisë serbe dhe forcave të UÇK-së [të shikohen regjistrimet]. Vedati me babanë Rizën ndenjën në shtëpi. Po atë ditë, Vedati u nis për ta vizituar gjyshen, e cila jetonte afër tyre [Pejë/Peç]. Ishte kjo hera e fundit kur Riza e shihte të birin. Katër ditë më vonë, policia e ka ftuar Rizën që ta identifikonte trupin e pajetë të Vedatit, i cili gjendej në shtëpinë e Jakup Ademit,